FLETORJA
E PIKËS SË UJIT



Klasa 3: Pika e Ujit dhe Aventurat e Saj

Emri im: _____

Shkolla ime: _____

Përshëndetje! Unë jam Pika.

Unë jam e vogël, por shumë e rëndësishme. Bie nga qielli si shi, jetoj në lumenj, dete dhe në tokë. Më gjen edhe në gotën tënde. Pa mua, asgjë e gjallë nuk jeton.



Trupi yt është ujë

Më shumë se gjysma e trupit tënd është ujë. Ti je pothuajse si një "shishe uji" që ecën! Uji të mban të fortë dhe të shëndetshëm.

A E DINI?

Nëse do të peshoje veten, rreth 6 nga çdo 10 kilogramë do të ishin ujë!

Aventura pa fund e Pikës

Një udhëtim që nuk mbaron kurrë...

Një ditë, Dielli e ngrohu Pikën dhe ajo u ngrit drejt qiellit si avull. Ky është AVULLIMI.

Lart ishte ftohtë. Pika u bashkua me pika të tjera dhe formuan një re. Ky është KONDENSIMI.

Kur reja u rëndua, Pika ra përsëri në tokë si shi. Këto janë RESHJET.

Ajo u kthye në lumë dhe u bashkua me shoqet e saj. Kjo është MBLEDHJA.


Por aventura nuk mbaroi… Dielli doli përsëri!

Ky udhëtim pa fund quhet CIKLI I UJIT.

"Pika, mbahu!" bërtitën shoqet e saj.

Por ishte tepër vonë...

Pik! Pik! Pik!



Ngjyros hapat e udhëtimit


Ngjyros diagramin më sipër me ngjyrat që dëshiron: diell verdhë, re bardhë, ujë blu. Vendosi numrat 1–4 në udhëtimin e Pikës.

Pika ushëton nëpër Kosovë

A e gjen dot ku jetojnë shoqet e Pikës?

Pika nuk jeton vetëm në një vend. Ajo udhëton nëpër lumenj, pushon në liqene, kërcen në ujëvara dhe fshihet edhe nën tokë!

SFIDA E PIKËS



Emërto dhe ngjyros

A njeh ndonjë lumë ose liqen afër vendit ku jeton? Shkruaj së paku një ose më shumë emërtime të lumenjëve.

A E DINI?

Ujëvarat e Mirushës dhe Liqeni i Batllavës janë vetëm dy nga vendet e bukura të ujit në Kosovë.

Uji i Dinozaurëve!

A ka pirë një dinozaur ujin tënd?

Pika ka një sekret për ty...

Uji nuk zhduket! Ai udhëton dhe ndryshon formë vazhdimisht. Prandaj, një pjesë e ujit që pimë sot mund të ketë qenë në Tokë edhe kur jetonin dinozaurët!



LOJË

Le të lëvizim pak!


Ngrihu dhe bëj këto lëvizje bashkë me Pikën:

1. Ngrihu në këmbë
2. Bëhu avull — ngriti duart lart
3. Bëhu re — përqafo veten
4. Bëhu shi — trokitni këmbët

SFIDA


A mund ta ndihmosh Pikën të arrijë në det? Shko te labirinti në faqen 7. Pika është nisur nga burimi dhe duhet të gjejë rrugën deri në det. Me laps, ndiq rrugën nga Pika deri te deti. Kujdes! Gjatë rrugës do të hasësh mbeturina dhe pengesa. Mos kalo nëpër to — gjej një rrugë tjetër!

Ndihmo pikën të arrijë tek deti!



Diçka po ndryshon
Uji po ndotet

Pika rrëshqet e lumtur përgjatë lumit, kur papritur ndalon. Çfarë është ajo në ujë? Mbeturina! Uji po ndotet dhe peshqit po largohen. Pika e kupton se diçka nuk është në rregull…



Kush e Ndotë Ujin?



Lojë
Gjeni ndotjen!

Bëhu detektiv i ujit! Shiko fotografinë me kujdes dhe gjej të gjitha gjërat që mund ta ndotin ujin. Sa prej tyre arrin të zbulosh?



Unë gjeta ___ gjëra që ndotin ujin!

TOKA – HEROI I FSHEHUR

A e dini?

Toka është një filtër natyror! Kur uji kalon nëpër të, disa papastërti mbeten mes shtresave të tokës, rërës dhe gurëve. Kështu, uji mund të bëhet më i kthjellët. Por kujdes! Edhe nëse duket i pastër, kjo nuk do të thotë se është i sigurt për t'u pirë.



MBAJE MEND!

Toka mund të ndalojë disa papastërti, por mbrojtja e ujit fillon nga ne!

Çdo ditë je hero i ujit
Tri gjëra të vogla që bëjnë ndryshim

Edhe veprimet e vogla bëjnë ndryshim!

Pika ka nevojë edhe për ndihmën tënde. Çdo ditë mund ta mbrosh ujin me këto 3 veprime:

1. Mbylle rubinetin

Kur lan duart me sapun, mbylle rubinetin. Hape vetëm për shpërlarje. Mjaftojnë 20 sekonda sapunim për duar të pastra!

2. Mos hidh mbeturina në ujë

Mbeturinat e hedhura afër lumit përfundojnë brenda tij. Peshqit dhe bimët ujore dëmtohen.

3. Ndaje atë që mësove

Kur të kthehesh në shtëpi, tregoju familjarëve për aventurën e Pikës dhe për mënyrat se si mund ta mbrojmë ujin së bashku.







SFIDA IME E HEROIT

Cilën do ta bësh sot? Vendos

- ☐ Do ta mbyll rubinetin.
- ☐ Nuk do të hedh mbeturina.
- ☐ Do t'i tregoj dikujt çfarë mësova.

Në fund, Pika mund të thotë:

TESTO VETEN

E Vërtetë apo e Gabuar?

Lexo secilën fjali dhe rretho:

Uji i pastër nuk harxhohet kurrë.	E VËRTETË / GABIM
Mbeturinat në tokë mund të përfundojnë në lumë.	E VËRTETË / GABIM
Çdo fëmijë mund të bëhet hero i ujit.	E VËRTETË / GABIM
Toka pastron çdo lloj ndotjeje, edhe vajin.	E VËRTETË / GABIM
Mbyllja e rubinetit ndihmon të kursejmë ujë.	E VËRTETË / GABIM



LOJË ME SHOKË

Familja e Ujit — Karta për të Prerë

Pika dëshiron të të prezantojë katër shokët e saj!

Priti kartat me kujdes, me ndihmën e një të rrituri, dhe fto shokët për të luajtur së bashku!

SI TË LUASH?

Gjeje çiftin!

Përzieji kartat dhe përpiqu të gjesh personazhet që shkojnë bashkë.

Shpik një histori!

Zgjidh disa karta dhe krijo një aventurë argëtuese me personazhet e ujit.

Trego çfarë di!

Zgjidh një kartë dhe trego diçka që ke mësuar për atë personazh.

Gati për lojë? Argëtohu me shokët e Pikës!



KARTAT E FAMILJES SË UJIT

Gati për lojë?

Në këtë faqe gjenden pjesët e pasme të kartave të Familjes së Ujit!

Me ndihmën e një të rrituri, prit me kujdes përgjatë vijave të ndërprera. Pastaj përzieji kartat, fto shokët dhe filloni lojën!

SFIDA E PIKËS:

A mund të tregosh çfarë roli ka secili personazh në udhëtimin e ujit?



NJË HAP MË LARG

Pika zbulon botën!

Aventura e Pikës nuk përfundon në Kosovë! Ajo udhëton nëpër botë dhe zbulon se uji është i rëndësishëm për të gjithë, por njerëzit dhe kafshët e përdorin dhe e sigurojnë atë në mënyra të ndryshme.

A E DINI SE...

Në disa fshatra të Afrikës, fëmijët duhet të ecin kilometra të tëra për të sjellë ujë për familjet e tyre.

Në Venecia të Italisë, varkat janë pjesë e jetës së përditshme! Njerëzit lundrojnë nëpër kanale për të lëvizur nga një vend në tjetrin.

Në disa shkolla të Japonisë, uji i shiut mblidhet dhe përdoret për të ujitur lulet dhe kopshtet.

Në shkretëtirë, disa kafshë janë përshtatur të jetojnë për një kohë të gjatë pa pirë ujë.



MBAJE MEND!

Uji na bashkon të gjithëve! Kudo që jetojmë, ai është i çmuar dhe duhet ta përdorim me kujdes.

DETYRA IME KRIJUESE - Uji Përmes Syve të Mi

Bëhu artist dhe trego përmes vizatimit tënd sa i rëndësishëm është uji!

Zgjidh një nga këto tema:

Si e përdor unë ujin me kujdes?

Lumi ose liqeni im i preferuar

Ujë i pastër për të gjithë!

Vizatimi yt mund të bëhet pjesë e ekspozitës!

Vizatimet më të mira do të prezantohen në ekspozitën shkollore “Fëmijët për Ujë të Pastër”.

Por aventura nuk përfundon këtu! Dy vizatimet më të mira nga secila shkollë do të përzgjidhen për të marrë pjesë në Kampin Veror mbi MIRU!



Fjalori i Vogël i Pikës

FJALORI I VOGËL:

Cikli i ujit: udhëtimi i pandërprerë i ujit nga toka, në qiell, e përsëri në tokë.

Avull uji: uji kur bëhet i lehtë si ajri dhe ngjitet lart.

Ndotje: kur uji bëhet i papastër nga mbeturina ose kimikate.

Filtrim: kur uji kalon nëpër diçka (si rëra) dhe bëhet më i pastër.

Vizato lumin tënd; Nëse njeh një lumë ose liqen afër shtëpisë, vizatoje këtu.



Tregoju Familjes Tënde

Heronjtë e Ujit nuk mësojnë vetëm për vete, ata i mësojnë edhe të tjerët!

Kur të shkosh në shtëpi, tregoju familjarëve për aventurën e Pikës dhe për atë që mësove sot. Shpjegoju pse uji është kaq i rëndësishëm, si mund të ndotet dhe çfarë mund të bëjmë të gjithë për ta kursyer dhe mbrojtur.

Sfidoje edhe familjen tënde:
A mund të zgjidhni së bashku një veprim të vogël që do ta bëni çdo ditë për ta mbrojtur ujin?
Veprimi i familjes sime:

_____



BETIMI I HEROIT TË UJIT

Unë premtoj:

ta kursej ujin,

të mos hedh mbeturina,

t'i mësoj edhe të tjerët.

Emri im: _____

Shkolla: _____

Data: _____